



Suedi  
Sverige



SANE  
27  
Supporting  
Albanian  
Negotiations  
in Environment

# Përgatitja e Pozicioneve Negociuese

## Tryeza e Diskutimit dhe Këshillimit për kapitullin 27

Tiranë, 28 janar 2025



# Pozicioni Negociues për Kapitullin 27

- Pozicioni Negociues është dokumenti që përgatitet në vijim të fazës së Shqyrtimit Analitik (Screening).
- Raporti i Shqyrtimit Analitik ka këto pjesë:
  - Përshkrimi i shkurtër i strukturës së kapitullit
  - Rezultatet e procesit të shqyrtimit analitik (bazuar mbi informacionin e dhënë nga Shqipëria)
  - Vlerësimin e Komisionit
  - Përfundimet dhe rekomandimet për Këshillin
- Pasi paraqitet Raporti i Shqyrtimit Analitik ka dy mundësi:
  - Raporti përmban Piketa Hapëse dhe për këtë arsye duhen menaxhuar këto piketa
  - Raporti nuk përmban Piketa hapëse dhe duhet kaluar në përgatitjen e Pozicionit Negociues
- Me Metodologjinë e re të gjitha pikat e mësipërme konsiderohen në nivel Grupkapitulli (IV)

# Përmbajtja e Pozicionit Negociues

- Pozicioni Negociues përgatitet në nivel Grupkapitulli pra së bashku me 3 kapitujt e tjerë
- Pozicioni Negociues është i ndarë në dy pjesë:

Pjesa e parë është më formale dhe paraqet dakordësinë e Shqipërisë me Acquis e BE-së (për Kapitullin 27 dhe kjo pjesë është shumë e rëndësishme) dhe përfshihet: (i) Deklarim Politik (në nivel nënkaptulli); (ii) Deklarimi mbi Pranimin e Acquis; dhe (iii) Integrimi i Përshpejtuar.

Pjesa e dytë e cila është pjesa shpjeguese dhe ka strukturën sipas asaj të kapitullit (strukturë e marrë kryesisht nga shqyrtimi analitik së bashku me ndryshimet që kanë ndodhur)

- Pjesa e dytë që është përgatitur nga GNPIE27 përmban informacionin sipas kësaj renditje: (i) Hyrja e nënkaptullit; (ii) Situata ligjore (për çdo akt); (iii) Situata Institucionale dhe Administrative (për çdo akt); (iv) sfidat kryesore; dhe (v) planet për të ardhmen për linjëzimin e plotë.

# Pozicioni Negociues

- Draft-i i parë është përgatitur që në shtator
- Gjatë muajit tetor- nëntor janë bërë rregullimet përkatëse në nivel nënkapitulli
- Afatet paraprake (për të gjithë Cluster-in) janë përcaktuar si më poshtë:
  - *Transpozimi i.e. kalimi në legjislacionin shqiptar të dispozitave të domosdoshme jo më vonë se 2027*
  - *Zbatimi dhe forcimi i aspekteve kryesore që lidhen me këto dispozita jo më vonë se 2029*
  - *Zbatimi i plotë për direktivat që kërkojnë periudhë tranzitore (bazuar në dokumentet specifike D(R)SIP)*
- Në dhjetor dokumenti u plotësua dhe me pjesën e identifikimit të akteve që kërkojnë periudha tranzitore
- Në fillim të janarit pati një përditësim të fundit bazuar mbi gjetjet e Raportit të Shqyrtimit Analitik

# Pozicioni Negociues



## Table of Contents

CHAPTER 27 - ENVIRONMENT AND CLIMATE CHANGE .....	3
1. ENVIRONMENT .....	3
1.1. Horizontal Legislation .....	4
1.2. Air Quality .....	10
1.3. Waste Management .....	15
1.4. Water Quality .....	30
1.5. Nature Protection .....	39
1.6. Industrial Pollution Control .....	48
1.7. Chemicals .....	54
1.8. Noise .....	65
2. CLIMATE CHANGE .....	67
2.1. Governance regulation .....	67
2.2. EU ETS - Emissions Trading System .....	69
2.3. Effort Sharing .....	69
2.4. EU Monitoring Mechanism .....	70
2.5. Carbon Capture and Storage .....	70
2.6. Fluorinated Gases .....	71
2.7. Ozone-Layer Protection .....	72
2.8. Fuel Quality .....	73
2.9. CO2 emissions from cars and vans and Heavy-Duty Vehicles .....	73
2.10. Land Use, Land Use Change and Forestry .....	74
3. CIVIL PROTECTION .....	75
3.1. Union Civil Protection Mechanism .....	75
4. OTHER .....	78
4.1. Life Regulation .....	78
4.2. Fighting corruption .....	78

- 4 nënkapituj
- Afërsisht 80 faqe (pa shtojcat)
- 69 tematika (një ose disa direktiva/rregullore)



# Hapat e mëtejshëm për PN

- Draft-i është nisur jo zyrtarisht për të marrë komentet
- Duhet filluar të analizohen masat dhe të detajohen hapat që duhen marrë për periudhën afatshkurtër 2025-2027
- Duhet filluar me identifikimin e dokumenteve për periudhat tranzitore dhe ato të përshtatjes
- Përditësimi i kërkesave të reja që lidhen me Acquis e re që kanë dalë gjatë periudhës qershor 2023 e në vazhdim
- Rishikimi i Pozicionit Negociues bazuar mbi komentet informale që do të vijnë gjatë vitit 2025
- Përgatitja për Konferencën Ndërqeveritare për Grupkapitullin IV

# Periudha kalimtare

- Nëse Shqipëria konsideron se për arsye të justifikueshme do të kërkojë një periudhë më të gjatë kohore për harmonizimin në një kapitull të caktuar, ai mund të kërkojë gjatë negociatave për atë kapitull të ashtuquajturat periudha kalimtare.
- Këto periudha kalimtare janë periudha shtesë në të cilat vendi kandidat do të përfundojë harmonizimin e legjislacionit kombëtar me *acquis* në një fushë të caktuar pas anëtarësimit në BE.
- Periudhat e kërkuara kalimtare duhet të jenë të kufizuara në kohë dhe qëllim dhe nuk duhet të ndërhyjnë në konkurrencën e tregut të lirë, as të ndikojnë në tregun e brendshëm të Komunitetit.
- Kapitulli 27 është nga të paktët që ka mundësi për periudha tranzitore
- Kryesisht periudhat kalimtare janë mundësuar për Direktivat dhe bazuar mbi një document specific (DSIP – *Directive Specific Implementation Plan*)
- DSIP janë pjesë përbërëse e dokumenteve të integritit

# Periudhat kalimtare të parashikuara

- ▶ Për momentin janë parashikuar periudha kalimtare për 26 akte ligjore (20 direktiva dhe 6 rregullore) të ndara si më poshtë:
  - Legjislacioni Horizontal (0 akte)
  - Cilësia e ajrit (3 direktiva)
  - Menaxhimi i Mbetjeve (7 Direktiva)
  - Cilësia e Ujit (8 Direktiva)
  - Mbrojtja e Natyrës (0 akte)
  - Kontrolli i Shkarkimeve Industriale (2 Direktiva)
  - Menaxhimi i Kimikateve (2 Rregullore)
  - Zhurmat (0 akte)
  - Ndryshimet Klimatike (4 Rregullore)



# Periudhat e përshtatjes

- Ndonjëherë rregulla të caktuara futen gradualisht, për t'i dhënë kohë anëtarit të ri për t'u përshtatur.
- Periudhat e kërkuara të përshtatjes duhet të jenë të kufizuara në kohë dhe qëllim (zakonisht janë shumë më të kufizuara sesa ato kalimtare).
- Në kapitullin 27 deri tani janë parashikuar të ketë kërkesa për periudhë përshtatje për 3 rregullore të kimikateve, 2 Direktiva të Natyrës dhe 2 rregullore të ndryshimeve klimatike
- Periudhat e përshtatjes për rregulloret e përmenduar lidhen kryesisht me sfidat teknike dhe të kapaciteteve, ndërkohë që për Direktivat e Natyrës me veçantitë që ka vendi ynë.

Pyetje dhe...  
Faleminderit për vëmendjen!